



UDHËRRËFYES

PËR TË DREJTAT E FAMILJARËVE
TË PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË
PERIUDHËS SË KOMUNIZMIT



UDHËRRËFYES

PËR TË DREJTAT
E FAMILJARËVE TË PERSONAVE
TË ZHDUKUR GJATË PERIUDHËS
SË KOMUNIZMIT



International Commission on Missing Persons



Funded by European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Embassy of Switzerland in Albania



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBË
DOKUMENTET E BIR-SIGURIMIT TË SHITËT

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|-----------|
| AKRONIME | 5 |
| PARATHËNIE | 7 |
| I. HYRJE | 9 |
| 1.1 Vështrim historik | 9 |
| 1.2 Cilat janë institucionet e krijuara nga Qeveria Shqiptare pas viteve '90 dhe përgjegjësitë e tyre me fokus të drejtat e viktimave dhe familjarëve të viktimave të periudhës komuniste? | 11 |
| II. Institucionet përgjegjëse për çështjen e personave të zhdukur dhe roli i tyre | 14 |
| 2.1 Cilat janë institucionet dhe roli i tyre në çështjen e personave të zhdukur? | 14 |
| 2.2 Cilat janë institucionet e tjera të përfshira në këtë proces dhe përgjegjësitë e tyre?..... | 17 |
| III. Shoqëria civile dhe roli i saj në kujtesën e personave të zhdukur | 19 |
| IV. Institucione ndërkombëtare të përfshira në proces | 22 |
| 4.1 Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur | 22 |
| 4.2 Partnerë të tjerë | 24 |
| V. Seksioni pyetje-përgjigje | 26 |
| 5.1 Kush konsiderohet person i zhdukur gjatë periudhës së komunizmit? | 26 |

| | | |
|--------------|--|-----------|
| 5.2 | Kush mund të raportojë për një person të zhdukur? | 27 |
| 5.3 | Ku mund të raportohet për gjetjen e një personi të zhdukur? | 27 |
| VI. | Kuadri ligjor aktual mbi personat e zhdukur gjatë periudhës së komunizmit | 30 |
| 6.1 | Të drejtat e familjeve që rrjedhin nga instrumentet ligjore ndërkombëtare. Cilat janë instrumentet ligjore ndërkombëtare që adresojnë çështjen e personave të zhdukur me forcë dhe të drejtat e familjarëve të tyre? | 30 |
| 6.2 | Cilat janë detyrimet e shteteve sipas parashikimeve të legjislacionit ndërkombëtar? | 32 |
| VII. | Të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur sipas legjislacionit të brendshëm | 36 |
| 7.1 | Çfarë të drejtash kanë sipas ligjit për kompensimin e ish-të dënuarve politikë? | 36 |
| 7.2 | Cilat janë të drejtat sipas ligjit nr. 7514, datë 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i ndryshuar | 40 |
| VIII. | A ka një proces të qartë në Shqipëri për të gjetur, për të rikuperuar dhe për të identifikuar mbetjet njerëzore të personave të zhdukur? | 47 |
| 8.1 | A ka Shqipëria detyrimin të hetojë rastet e personave që u zhdukën gjatë periudhës së regjimit komunist? | 48 |
| 8.2 | A ekziston një parashkrim që i ndalon prokurorët të hetojnë rastet e personave të zhdukur nga periudha komuniste? | 48 |
| 8.3 | Cilat janë parimet e praktikave më të mira që duhet të zbatohen për të adresuar çështjen e personave të zhdukur në Shqipëri? | 49 |

AKRONIME

| | |
|----------------|--|
| AIDSSH | Autoriteti për Informimin mbi Dosjet e Ish-Sigurimit të Shtetit |
| BE | Bashkimi European |
| CAT | Komiteti i OKB-së kundër Torturës |
| KEDNJ | Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut |
| ICMP | Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur |
| ISKK | Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit |
| IIPP | Instituti i Integritit të të Përndjekurve Politikë |
| KIDPP | Komiteti i ish-të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë |
| UNWGEID | Grupi i Punës i OKB-së për Zhdukjet e Detyruara ose të Pavullnetshme |

PARATHËNIE

Publikimi i këtij Udhërrëfyese është i pari i këtij lloji në Shqipëri dhe mundësohet falë projektit “Rritja e ndërgjegjësimit publik për drejtësinë tranzicionale dhe pajtuese: Adresimi i çështjes së personave të zhdukur nga periudha komuniste”, financuar nga Bashkimi Europian dhe Qeveria e Zvicrës, i zbatuar nga ICMP dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Sigurimit të Shtetit.

Projekti synon të rrisë ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare për krimet e komunizmit dhe pasojat e rënda për shoqërinë shqiptare, me fokus të pagjeturit e diktaturës.

Për këtë qëllim, vendet e kujtesës, si burgjet dhe kampet e internimit ku të dënuarit e ndërgjegjës mbaheshin mbyllur edhe për shkak të lidhjeve familjare apo shoqërore, duhet të jenë të njohura dhe të vizitueshme për shoqërinë shqiptare.

Vendet që ende ruajnë prova të prekshme të së kaluarës së errët dhe ato ku mijëra të tjerë humbën jetën, duhet të përkujtohen, të ruhen në mënyrën e duhur, të muzealizohen...

Synimi parësor i projektit ka të bëjë me rritjen e pjesëmarrjes së grupeve të shoqërisë civile dhe pjesëtarëve të familjeve të personave të zhdukur, mes të cilëve grave, në proceset e drejtësisë tranzicionale dhe pajtuese në Shqipëri.

Në të njëjtën kohë, ICMP në bashkëpunim me AIDSSH vijon punën për rritjen e njohurive të institucioneve shtetërore (qeveri, zyra të prokurorëve dhe të tjerë që merren me çështjen e personave të zhdukur) sa u takon detyrimeve ligjore dhe të drejtave të njeriut të familjeve të personave ende të pagjetur.

Ky Udhërrëfyes, - i cili shpresojmë t'u vijë në ndihmë familjarëve të personave të zhdukur apo ekzekutuar gjatë regjimit komunist 1944-1991, për të njohur më mirë të drejtat e tyre e për t'i ushtruar ato efektivisht, - është produkt i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

ICMP ka kontribuar në hartimin e udhërrëfyesit, nëpërmjet rekomandimeve për përmbajtjen dhe strukturën e tij, bazuar në modele të ngjashme të botimeve të tilla në rajon.

GENTIANA SULA
Kryetare e Autoritetit

1

HYRJJE

1.1 Vështrim historik

Neni 1 i Konventës Ndërkombëtare të OKB-së “Për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë¹” parashikon se:

1. *Askush nuk do të jetë subjekt i një zhdukjeje me forcë.*
2. *Asnjë rrethanë e jashtëzakonshme, e çfarëdo lloji, qoftë gjendje lufte a rrezik lufte, paqëndrueshmëri e brendshme politike ose çdolloj tjetër gjendjeje e jashtëzakonshme, nuk mund të nxirret si justifikim për një zhdukje me forcë.*

Shqipëria e pas-Luftës së Dytë Botërore, me vendosjen e regjimit komunist e deri në vitin 1990, u kthye në një nga vendet me sistemin diktatorial më të egër në Europë, ku kundërshtarët e regjimit u burgosën, u internuan e shumë prej tyre u vranë, shpesh arbitrarisht, në mungesë të një vendimi gjyqësor e në mungesë të dijenisë së familjarëve të tyre, duke shkaktuar plagë të mëdha në shoqërinë shqiptare.

¹ Ligj nr. 9802, datë 13.9.2007, “Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare të OKB-së ‘Për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë’”.

Në periudhën 1944-1991, mbi 6.000 persona u ekzekutuan në Shqipëri me ose pa urdhër të gjykatës (kryesisht me pushkatim ose varje) dhe trupat e tyre nuk iu kthyen pothuajse asnjëherë familjeve të tyre për varrim. Sipas Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK) në Shqipëri, 5.577 meshkuj dhe 450 femra u dënuan me vdekje dhe u vranë. Ka edhe raporte të shumta ku thuhet se të burgosur politikë vdiqën në burgjet apo kampet e punës si rezultat i torturave apo shkaqeve të tjera, si për shembull vetëvrasje. Edhe në këto raste trupat nuk i ktheheshin familjes, sepse në regjimin komunist trupi i të dënuarit mbetej në dispozicion të shtetit gjatë gjithë kohëzgjatjes së dënimit edhe në qoftë se ai vdiste².

Ballafaqimi me të kaluarën është një detyrim ligjor, por edhe moral, për të gjitha grupet shoqërore, si parakusht për arritjen e paqes sociale në vend. Zbardhja e fatit të personave të zhdukur do të vendoste drejtësi për të gjithë familjarët e tyre. Edhe pse që pas vitit 1991 janë ndërmarrë hapa ligjorë e institucionalë për të garantuar ushtrimin e të drejtave nga viktimat e komunizmit e familjarët e tyre, ende ka shumë për të bërë. Një sfidë e madhe ka qenë dhe mbetet gjetja, identifikimi dhe rikuperimi i trupave të të zhdukurve gjatë periudhës së komunizmit, ku deri më sot vetëm një numër i vogël i tyre janë zbuluar e identifikuar përmes përpjekjeve *ad-hoc* të kryera nga familjet e të zhdukurve.

Për këtë qëllim, u hartua dhe u miratua në vitin 2018 Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Qeverisë Shqiptare dhe ICMP për gjetjen e personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste në Shqipëri, midis periudhës 29 nëntor 1944 dhe 2 korrik 1991, duke përcaktuar në veçanti rregullat e bashkëpunimit për identifikimin, gjetjen e personave të humbur, si dhe koordinimin e punës me organet e tjera shtetërore.

²Ekspozitë historike. "Të dënuarit me vdekje dhe të zhdukurit | Bunk'art, aksesuar së fundmi më 4 prill 2021.

Në vazhden e këtyre përpjekjeve, u miratuan në korrik 2020 ndryshimet në ligjin nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ku Autoriteti bashkëpunon me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore për procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për marrjen e masave për të mbrojtur dhe për të ruajtur në mënyrën më të përshtatshme vendet që janë aktualisht apo do të identifikohen si vendvarrime.

1.2 Cilat janë institucionet e krijuara nga Qeveria Shqiptare pas viteve '90 dhe përgjegjësitë e tyre me fokus të drejtat e viktimave dhe familjarëve të viktimave të periudhës komuniste?

Pasi u vendos demokracia ishte e nevojshme të ngrihej një institucion qendror shtetëror për të organizuar kompensim dhe rehabilitim për të gjithë personat që ishin akuzuar padrejtësisht për arsye politike nën regjimin komunist. Qëllimi ishte të sigurohej që ish-të përndjekurit politikë të merrnin përparësi dhe të pajiseshin me ndihmë materiale dhe morale, dhe të integroheshin plotësisht në shoqërinë demokratike. Institucionet ekzistojnë për një periudhë të kufizuar kohore dhe kishin për detyrë të zbatonin ligjet e miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave, mbi mbrojtjen e të drejtave civile të familjeve të viktimave si bazë për rivendosjen e një shoqërie të lirë dhe demokratike.

Nga janari i vitit 1993 deri në dhjetor të vitit 1994 u krijua dhe funksionoi Komiteti i ish-të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë. Në këtë periudhë parlamenti dhe qeveria miratuan:

- Ligji nr. 7748, datë 29.07.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i ndryshuar, dhe
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 04.05.1994, “Për dhënien e kompensimit pasuror ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”.

Më pas, në dhjetor 1997, u krijua Instituti për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë, i cili është në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe ka për detyrë të marrë të gjitha masat dhe të ndjekë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish-të përndjekurve politikë nga regjimi komunist.

IIPP-ja përpunon dhe trajton çështjet themelore që kanë të bëjnë me ish-të përndjekurit politikë nga regjimi komunist, në bashkëpunim me shoqatat kombëtare të ish-të përndjekurve politikë, që kanë shtrirje në të gjithë Shqipërinë. Ligji bazë më i rëndësishëm ku bazohet veprimtaria e këtij institucioni është ligji nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar. Qëllimi i këtij ligji është dhënia e dëmshpërblimit financiar nga shteti shqiptar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, për familjarët e viktimave të ekzekutuara dhe personat e internuar ose të dëbuar në kampe, si një angazhim i shtetit demokratik në dënimin e krimeve të regjimit totalitar komunist dhe garantimin për ta të një jete më të mirë.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit u krijua më 2015, menjëherë pas miratimit të ligjit nr. 45, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar (këtu e në vijim referuar si “ligji

45/2015”), i cili është ligji bazë i funksionimit të këtij institucioni. AIDSSH është person juridik publik, i pavarur, përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to.

Me ndryshimet e fundit ligjore, në korrik 2020, të ligjit 45/2015, mandati i Autoritetit u zgjerua për të përfshirë bashkëpunimin me institucionet shtetërore qendrore dhe lokale për procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për të marrë masa për të mbrojtur dhe për të ruajtur në mënyrë adekuate vendet që aktualisht janë identifikuar ose do të identifikohen si vendet e varrimit.

2

INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR ÇËSHTJEN E PERSONAVE TË ZHDUKUR DHE ROLI I TYRE

2.1 Cilat janë institucionet dhe roli i tyre në çështjen e personave të zhdukur?

Policia e Shtetit, veprimtaria e së cilës është e përqendruar në parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale. Për këtë arsye, policia duhet të ndër marrë veprime të duhura hetimore në lidhje me rastet e personave të zhdukur në përputhje me ligjin për Policinë e Shtetit, si dhe Kodin e Procedurës Penale. Detyrimi i saj për të bashkëpunuar në këtë proces buron dhe nga ligji nr. 83/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)” (këtu e në vijim “ligji 83/2018”), ku Policia e Shtetit edhe në relacionin bashkëngjitur këtij ligji cilësohet si një nga institucionet kryesore për t’u angazhuar në zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Prokuroria është organi i ndjekjes penale. Disa nga dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi, mbi bazën e të cilave lind detyrimi i organit të prokurorisë për t'u angazhuar në këtë proces, janë të përshkruara si më poshtë:

Gërmimet dhe ekzaminimi mjekoligjor i mbetjeve të gjetura njerëzore për të përcaktuar shkaku dhe mënyrën e vdekjes janë një komponent thelbësor i llogaridhënies për personat e zhdukur në përputhje me garancitë e të drejtave të njeriut. KPP e Shqipërisë e detyron prokurorinë që të zhvillojë dhe të kontrollojë hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore dhe të kryejë çdo veprim hetimor që ajo e vlerëson si të domosdoshëm (**neni 24**), i cili përfshin urdhërimin e zhvarrosjes së mbetjeve njerëzore, në mënyrë që të mundësojë ekzaminimin e mbetjeve njerëzore nga prokurori në prani të një mjeku ligjor (**neni 200**). Në përputhje me KPP, institucionet e vetme kompetente që mund të bëjnë një gërmim në përputhje me standardet e sundimit të ligjit janë Zyrat e Prokurorive të Qarkut³.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në **nenin 148** të saj, paragrafët 1, 2 dhe 3, parashikon si vijon:

1. *Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.*
2. *Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.*
3. *Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.*

³ <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2021/03/icmp-gr-wb-152-6-alb-W-doc-albania-missing-persons-from-the-communist-era-a-needs-assesment.pdf>.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në **nenin 1** të tij “Detyrat e legjislacionit procedural penal”, përcakton se:

- 1. Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit.*

Ndërsa në kreun II, **neni 24** – Prokurori – “Funksionet e prokurorit”, parashikohet:

- 1. Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm.*

Gjithashtu, vlen të theksohet se **neni 2** i ligjit 83/2018 përkufizon *Institucione të tjera të përfshira në zbatimin e kësaj marrëveshjeje, si autoritetet kombëtare, qendrore dhe vendore dhe autoritete të tjera përgjegjëse sipas legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Prokurorinë e Përgjithshme, Institutin për Mjekësinë Ligjore, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Drejtësisë dhe çdo institucion tjetër, bashkëpunimi i të cilit do të kërkohet për këtë marrëveshje.*

Në **nenin 3** të ligjit 83/2018, “Përgjegjësitë e autoriteteve shqiptare”, ndër të tjera, parashikohet:

Autoritetet shqiptare do të: ... Respektojnë ligjin vendas në hetimin e rasteve të personave të zhdukur...

Gjykatat janë institucionet e dhënies së drejtësisë në bazë të vendimeve të tyre. Në rastet e gjykimit të çështjeve penale, mbi bazën e fakteve dhe provave të paraqitura nga organi i Prokurorisë ato vendosin mbi fajësinë apo jo të autorëve të veprës penale.

2.2 Cilat janë institucionet e tjera të përfshira në këtë proces dhe përgjegjësitë e tyre?

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me ndryshimet e fundit në ligjin e tij bazë “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH-së”, ka marrë një rol të ri, koordinues, me të gjitha institucionet e tjera shtetërore për procesin e gjetjes, identifikimit dhe rikuperimit të trupave të të zhdukurve gjatë periudhës së komunizmit.

Neni 22/1 i ligjit 45/2015, “Bashkëpunimi për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve, si dhe masat për ruajtjen e vendvarrimeve” (shtuar me ligjin nr. 114/2020, datë 29.7.2020), parashikon:

- 1. Autoriteti bashkëpunon me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore për procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për marrjen e masave për të mbrojtur dhe për të ruajtur në mënyrën më të përshtatshme vendet që janë aktualisht apo do të identifikohen si vendvarrime.*
- 2. Rregullat e bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit dhe institucioneve qendrore dhe vendore për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të zhdukur gjatë komunizmit parashikohen në marrëveshje dy-apo-shumëpalëshe të lidhura për këtë qëllim.*
- 3. Autoritetet përgjegjëse dhe mënyra e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuar ose të dyshuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

Me marrjen e këtij roli të ri ka filluar adresimi i shumë kërkesave ndaj Autoritetit, të bëra nga familjarët e viktimave të vrara e të zhdukura gjatë periudhës së komunizmit, të cilët kërkojnë që nëpërmjet anga-

zhimit të këtij institucioni të mund të gjenden trupat e zhdukur të familjarëve të tyre.

Organi e vetëqeverisjes vendore – bashkitë janë edhe ato të përfshira në procesin e gjetjes, identifikimit dhe rikuperimit të trupave të të zhdukurve, nëpërmjet veprimeve administrative të kryera prej tyre, si përgjegjëse të çdo veprimtarie mbi territorin ku ato ushtrojnë funksionet e tyre⁴.

Për shembull, në rastin e gjetjes së një vendvarrimi (identifikimit të trupit të një apo disa të zhdukurve), kryetari i njësisë vendore mund të nevojitet të autorizojë zhvarrimin dhe të mbështesë, nëse është e mundur, procesin me mjetet e nevojshme.

“Kufomat mund të zhvarrosen përpara periudhës së caktuar, me urdhër të gjyqtarit ose prokurorit, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale ose me autorizimin paraprak të kryetarit të njësisë bazë të qeverisjes vendore, për t’i transportuar në varr tjetër⁵.”

Instituti i Mjekësisë Ligjore, krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 680, datë 2.9.2020, ka një rol të rëndësishëm në *procesin e identifikimit të eshtrave të të zhdukurve*, pasi ata kanë detyrën e marrjes së mostrave dhe kryerjen e ekspertizës mjekoligjore, për të dalë më pas në një konkluzion të saktë të kohës, kushteve/ rrethanave të vrasjes së viktimës si dhe të dhënave të tjera si: mosha, gjinia, përmasat trupore, apo dhe identitetit të saktë të viktimës në rast të kryerjes së analizës së ADN-së.

⁴ Ligji nr. 9220, datë 15.4.2004, “Për administrimin e shërbimit të varrimit” (ndryshuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014). **Neni 17/4** dhe **neni 18**. Shiko linkun: <https://www.vendime.al/43324/>

⁵ Ibid **Neni 18/1**.

3

SHOQËRIA CIVILE DHE ROLI I SAJ NË KUJTESËN E PERSONAVE TË ZHDUKUR

Në muajt e parë të vitit 1991, me fillimin e pluralizmit politik, krahas krijimit të disa partive, nisi edhe krijimi i shoqatave të shtresave të ndryshme shoqërore. Një grup nismëtarësh ish-të burgosur politikë krijoi Shoqatën e ish-të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, që përmblihte trashëgimtarët e të pushkatuarve politikë, ish-të burgosurit politikë dhe të internuarit e të dëbuarit për motive politike. Vite më pas u krijua një shoqatë tjetër e cila u quajt Shoqata Antikomuniste e ish-të Përndjekurve Politikë Demokratë.

Ndërkohë, ish-të burgosurit dhe të përndjekurit politikë u çorientuan dhe nuk dinin nga të shkonin. Në këto kushte, lindi nevoja që ish-të burgosurit politikë të krijonin shoqatën e tyre, e cila u miratua nga gjykata me emërtimin e thjeshtë Shoqata e ish-të Burgosurve Politikë të Shqipërisë. Kjo shoqatë e pavarur, joqeveritare dhe jofitimprurëse, bashkonte ish-të burgosurit politikë dhe familjarët e tyre, me qëllim që të punonin së bashku për fitimin e të drejtave themelore dhe për një integrim të vërtetë. Shoqata e ish-të Burgosurve Politikë të Shqipërisë mori nismën ligjore dhe hartoi pro-

jektligjin e parë për dëmshtëpërblimin e trashëgimtarëve të të pushkatuarve politikë, ish-të burgosurit dhe të internuarit për motive politike. Është ai projektligj, i ndryshuar pjesërisht nga qeveria dhe i jetëzuar me ligjin 9831, datë 13/12/2007⁶.

Mbas këtyre shoqatave janë krijuar edhe disa të tjera, si ajo e Trashëgimtarëve të të Pushkatuarve Politikë, e Dëbim-Internimeve, e Ish-Kulakëve etj. U krijuar edhe Shoqata Mbarëkombëtare e Integritit të të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë. Pastaj kjo shoqatë u nda më dysh: gjysma e parë mbajti po atë emërtim; ndërsa gjysma tjetër mbajti emërtimin Unioni Mbarëkombëtar i Integritit të të Përndjekurve Politikë.

Disa prej këtyre shoqatave aktualisht pothuajse janë inaktive, por fillimisht ato kanë pasur një jetë aktive lidhur me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave të komunizmit, si: të burgosur, të përndjekur, të internuar e të ekzekutuar nga regjimi komunist.

Po kështu, ekzistojnë edhe Shoqatat Familjare, të cilat janë organizata joqeveritare të shoqërisë civile që mblidhen për të përfaqësuar interesat e familjeve të personave të zhdukur. Ato janë rrjete joformale të përkrahjes së individëve të prekur dhe llobojnë që autoritetet shtetërore t'i kryejnë detyrimet e tyre për të hetuar rastet e personave të zhdukur, për të gjetur, për të zhvarrosur dhe për të identifikuar personat e zhdukur.

Shumë prej tyre janë të përfshira gjithashtu në arkivitetet e Ditës së Kujtesës (Remembrance Day). Nëpërmjet veprimtarive të tyre ato synojnë të nderohen viktimat, përfshirë edhe personat e zhdukur, por gjithashtu të inkurajojnë debatin shoqëror të ballafaqimit me të kaluarën, pandëshkueshmërinë dhe llogaridhënien.

⁶ <https://www.ballikombetar.info/mbi-gjendjen-e-shoqatave-te-te-perndjekurve-politike/>

Shoqata Antikomuniste e të Përndjekurve Politikë dhe Organizatat Joqeveritare të Kujtesës së Diktaturës synojnë të zgjerojnë aktivitetet e tyre në mënyrë të shprehur për të adresuar çështjet e personave të zhdukur. Ato dëshirojnë në veçanti të përfshihen në aktivitete përkujtimore dhe në shkëmbimin e të dhënave me autoritetet shtetërore në mënyrë që të krijohen regjistrime të sakta mbi personat e zhdukur për qëllime historike dhe praktike⁷.

⁷ <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2021/03/icmp-gr-wb-152-6-alb-W-doc-albania-missing-persons-from-the-communist-era-a-needs-assesment.pdf>.

4

INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE TË PËRFSHIRA NË PROCES

4.1 Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur

Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) punon me qeveritë, organizatat e shoqërisë civile, institucionet e drejtësisë, organizatat ndërkombëtare dhe të tjerë në të gjithë botën për të adresuar çështjen e njerëzve që janë zhdukur si rezultat i konfliktit të armatosur, *abuzimeve të të drejtave të njeriut*, katastrofove, krimit të organizuar, migrimit të parregullt dhe shkaqeve të tjera. Si e vetmja organizatë ndërkombëtare që ka për detyrë ekskluzive të adresojë këtë çështje, ICMP është e angazhuar në mënyrë aktive në zhvillimin e institucioneve dhe kapaciteteve të shoqërisë civile, promovimin e legjislacionit, nxitjen e advokimit shoqëror dhe politik dhe zhvillimin dhe sigurimin e ekspertizës teknike për të gjetur dhe për të identifikuar të zhdukur. ICMP punon me qeveritë për të zhvilluar kapacitetin e tyre institucional për të adresuar çështjen e personave të zhdukur në mënyrë efektive dhe të paanshme⁸.

⁸ <https://www.icmp.int/about-us/>.

ICMP ndihmon qeveritë të krijojnë legjislacion për të mbrojtur të drejtat e familjeve të të zhdukurve dhe punon me organizata të shoqërisë civile për t'i fuqizuar ato që të avokojnë për të drejtat e tyre. Ndhmon procesin e drejtësisë duke siguruar që qeveritë t'i përmbahen një qasjeje të bazuar në rregullin e ligjit për hetimin e zhdukjeve. ICMP ndihmon drejtpërdrejt qeveritë në punën në terren. ICMP mban një Qendër Unike, të Specializuar të Kërkimit Online (OIC) dhe Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave të Identifikimit (iDMS) që menaxhon të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me procesin e personave të zhdukur. ICMP gjithashtu ofron programe trajnimi dhe edukimi për një gamë të gjerë individësh, duke përfshirë autoritetet qeveritare, prokurorët dhe gjykatësit, OJQ-të, familjet e personave të zhdukur dhe mjekët ligjorë⁹.

Për herë të parë ICMP u vu në kontakt me autoritetet e qeverisë shqiptare në vitin 2010. Bashkëpunimi i qeverisë shqiptare me ICMP formalisht u zyrtarizua në vitin 2018 me miratimin e ligjit nr. 83/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)”.

Kjo marrëveshje synon intensifikimin e përpjekjeve për gjetjen e personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste në Shqipëri midis datave 29 nëntor 1944 dhe 2 korrik 1991, duke përcaktuar në veçanti rregullat e bashkëpunimit për identifikimin, gjetjen e personave të zhdukur, si dhe për koordinimin e punës me organet kompetente.

Në vitin 2019 ICMP, mbështetur financiarisht nga BE, bëri të mundur identifikimin e eshtrave të dy prej 13 trupave të të zhdukurve, të gjetur në varrin masiv të Dajtit.

Aktualisht, ICMP, në bashkëpunim të ngushtë me AIDSSH, vazhdon përpjekjet për gjetjen dhe identifikimin e trupave të tjerë të të zhdukurve gjatë periudhës së komunizmit.

⁹Ibid.

4.2 Partnerë të tjerë

Grupi i Punës i OKB-së për Zhdukjet e Detyruara ose të Pavull-netshme (UNWGEID) është një mekanizëm i krijuar nga OKB-ja për të ekzaminuar pyetjet në lidhje me zhdukjet e detyruara ose të pavullnetshme të personave, bazuar në rezolutën 20 (XXXVI) të 29 shkurtit 1980. Rezoluta e fundit që rinovon mandatin e Grupit të Punës, A / HRC / RES / 45/3, u miratua nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut në tetor 2020.

Një nga detyrat kryesore të UNWGEID është të ndihmojë familjet në përcaktimin e fatit ose vendndodhjes së anëtarëve të familjes së tyre që thuhet se janë zhdukur. Në atë kapacitet humanitar, Grupi i Punës shërben si një kanal komunikimi midis anëtarëve të familjes së viktimave të zhdukjes me forcë dhe burimeve të tjera që raportojnë raste të zhdukjeve, dhe qeverive të interesuara. Për këtë qëllim, Grupi merr, shqyrton dhe transmeton te qeveritë raportet e zhdukjeve me forcë të paraqitura nga të afërmit e personave të zhdukur ose organizatat e të drejtave të njeriut që veprojnë në emër të tyre. Grupi i Punës u kërkon qeverive që të kryejnë hetime dhe të informojnë Grupin e Punës për rezultatet. Grupi i Punës ndjek kërkesat për informacion në bazë periodike. Ato raste mbeten të hapura në bazën e të dhënave të Grupit të Punës derisa të përcaktohet fati ose vendndodhja e personit.

Në raportin e vitit 2016 të këtij organizmi hartuar për Shqipërinë citohet shprehimisht se: *Grupi i Punës inkurajon Shqipërinë të miratojë dispozita që shprehin shprehimisht se zhdukja me forcë është një krim i vazhdueshëm ndaj të cilit nuk mund të zbatohen amnistitë dhe imunitetet, në mënyrë që kuadri i ligjit penal për parandalimin, hetimin dhe ndëshkimin e zhdukjes me forcë të jetë i plotë. Është e rëndësishme që legjislacioni i brendshëm të interpretohet dhe të zbatohet në përputhje me të drejtën ndërkom-bëtare. Është çështje për të ardhur keq që ligji penal nuk është*

testuar në praktikë. Grupi i Punës konstaton me keqardhje se, me gjithë numrin e madh të personave të zhdukur me forcë nga regjimi autoritar përpara se të mbaronte në fillim të viteve 1990, asnjë çështje e zhdukjes me forcë nuk është gjykuar në gjykatat shqiptare¹⁰.

(Shih referencën më poshtë për raportin e plotë.)

Qeveria shqiptare dha komente mbi raportin në korrik 2017, komente që mund të gjenden këtu¹¹.

¹⁰ Report of the Working Group on Enforced or Involuntary Disappearances on its mission to Albania, publikuar në korrik 2017, fq. 6.

¹¹ Përgjigja e Shqipërisë [1710726 \(refworld.org\)](https://www.refworld.org/docid/1710726.html).

5

SEKSIONI

PYETJE-PËRGJIGJE

5.1 Kush konsiderohet person i zhdukur gjatë periudhës së komunizmit?

Në Shqipëri nuk ka një ligj specifik mbi personat e zhdukur gjatë regjimit komunist që përcakton se kush do të konsiderohet person i zhdukur gjatë kësaj periudhe.

Sipas ligjit nr. 114/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 45, datë 30.4.2015, ‘Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë’”, për herë të parë jepet ky përkufizim:

“Person i zhdukur”, sipas fushës së veprimit të këtij ligji, është personi i arrestuar, i burgosur, i rrëmbyer ose të cilit i është hequr liria në çdo formë tjetër nga agjentë të shtetit apo nga persona të tjerë a grupe personash, që kanë vepruar me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e shtetit, pasuar nga mohimi i pranimit të heqjes së lirisë ose nga fshehja e fatit të personit të zhdukur a e vendit ku gjendet ai, duke e shkëputur nga mbrojtja e ligjit.

5.2 Kush mund të raportojë për një person të zhdukur?

1. Anëtari i familjes së personit të zhdukur ka të drejtë të raportojë për këtë çështje, referuar ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar. Bazuar në **nenin 22** të këtij ligji, radha e përparësisë është kjo: a) bashkëshortët; b) fëmijët; c) fëmijët e fëmijëve, kur personat e parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur; ç) prindërit, kur personat e parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur; d) vëllezërit dhe motrat, kur personat e parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur; dh) fëmijët e vëllezërve dhe motrave, kur personat e radhëve të mësipërme kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur.

2. Autoritetet përgjegjëse shtetërore, si: Policia e Shtetit, Autoriteti i Dosjeve, IPP, sipas fushës së veprimtarisë së tyre të rregulluar me ligj apo akte nënligjore.

5.3 Ku mund të raportohet për gjetjen e një personi të zhdukur?

Kërkesa mund t’i drejtohet:

- Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Adresa: info@autoritetidosjeve.gov.al
- Institutit të Integritit të të Përndjekurve Politikë. Adresa: Rr. “Xhorxh W. Bush”, Vila 2-kateshe nr. 7, Tiranë, e-mail: info@ishperndjekurit.gov.al

The image shows the official website of the International Commission on Missing Persons (ICMP) in Albanian. The main navigation bar includes 'Home', 'About us', 'What we do', 'Where we work', 'The Missing', 'News', 'Resources', and 'Contact'. The 'Raporto Personin e Zhdukur' (Report Missing Person) section is highlighted in the left sidebar. The main content area features a form titled 'TË DHËNAT PËR PERSONIN E ZHDUKUR' (Data for Missing Person). The form fields are as follows:

- Mbledhje:
- Gërmëzimi alternativ:
- Emri:
- Mashkull:
- Data e lindjes:
 - Viti: (nëse e panjohur lëreni bosh)
 - Muaji: (nëse e panjohur lëreni bosh)
 - Dita: (nëse e panjohur lëreni bosh)

Figura 1. Raportimi i Personave të Zhdukur në faqen zyrtare të ICMP.

- Mund të raportohet edhe te Qendra e Kërkimit Online të ICMP-së, shpjeguar si më poshtë:

Qendra e Kërkimit Online (QKO) e ICMP-së është një mjet për të ofruar ose për të marrë informacione për personin e zhdukur. Është një burim online i cili mund të përdoret nga familjet e personave të zhdukur.

E zhvilluar në bazë të përvojës së gjatë të ICMP-së në ndihmë të familjeve të personave të zhdukur, QKO është vendi ku mblidhen dhe ruhen informacionet konkrete dhe të dobishme të cilat mund të përdoren kur është e nevojshme në kërkimin e personave të zhdukur.

Në seksionin “Kërkesa” mund të raportohet mbi personin e zhdukur duke dhënë detaje, për shembull, emrin, datën e lindjes, vendin ku personi i zhdukur u pa për herë të fundit. Nëse ka informacion shtesë për personin e zhdukur, mund të paraqitet edhe ai. ICMP do ta ndajë këtë informacion me të tjerët vetëm me dakordësinë e aplikuesit.


Në seksionin e kërkimeve, mund të bëhen tri gjëra të ndryshme:

1. Mund të raportohet për personin e zhdukur duke dhënë detaje, si p.sh emrin, datën e lindjes, vendin ku është parë për herë të fundit personi i zhdukur;
2. Mund të jepen informacione shtesë për personin e zhdukur i cili është i regjistruar në QKO; dhe
3. Aplikuesi mund të kontrollojë statusin e personit të zhdukur për të parë nëse i afërmi ka përputhje të ADN-s.¹²

- Grupi i Punës së OKB-së për Zhdukjet e Detyruara ose të Pavullnetshme.

Ky organizëm pranon raste nga çdo vend në botë. Nuk është e nevojshme të shtrohen mjetet juridike vendase, përpara se një rast të paraqitet te Grupi. Rastet e zhdukjes mund të paraqiten nga të afërmit e të zhdukurve, ose nga organizatat që veprojnë në emër të tyre.

Formulari për t'u plotësuar mund të gjehet në linkun: http://www.ohchr.org/Documents/issues/Disappearances/Communication_form_E.doc, i cili më pas dërgohet me e-mail.



The screenshot shows the website of the International Commission on Missing Persons (ICMP). The page is titled "Kërkimi i Personit të Zhdukur" (Search for Missing Person). It features a search form with the following fields and buttons:

- Emri:** A text input field for the name.
- Gërmëzimi alternativ:** A text input field for alternative names.
- Mbiemri:** A text input field for the surname.
- Kërko:** A blue button to submit the search.
- Kodi i verifikimit:** A field with a dropdown menu and a "Tërhiqe" (Refresh) button.

Below the search form, there is a section titled "Rezultatet e Kërkimit (0)" (Search Results (0)). It contains a table with columns: Emri, Emri i Babait, Mbiemri, Data e Raportuar e Zhdukjes, and Vendi i Raportuar i Zhdukjes. Below the table, there is a red message: "Ju lutem shënoni të dyja Emrin, Mbiemrin ose vetëm kodin e konfirmimit!" (Please mark both the Name, Surname or just the confirmation code!).

Figura 2. Kërkimi i Personit të Zhdukur në faqen zyrtare të ICMP.

¹² Qendra e Kërkimit Online të ICMP-së <https://oic.icmp.int/index.php?w=intro&l=al>.

6

KUADRI LIGJOR AKTUAL MBI PERSONAT E ZHDUKUR GJATË PERIUDHËS SË KOMUNIZMIT

6.1 Të drejtat e familjeve që rrjedhin nga instrumentet ligjore ndërkombëtare. Cilat janë instrumentet ligjore ndërkombëtare që adresojnë çështjen e personave të zhdukur me forcë dhe të drejtat e familjarëve të tyre?

Në Shqipëri, traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, kur rati-fikohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, bëhen pjesë e legjislacionit të brendshëm pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shqipëria ka ratifikuar të gjitha traktatet kryesore ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut dhe traktate të tjera të rëndësishme, duke përfshirë Marrëveshjen Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike; Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese; katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe protokollat e tyre shtesë; Statutin e Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare; Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore; dhe Konventën Europiane për Parandalimin e Torturës

dhe Trajtimit Çnjerëzor, Degradues ose Ndëshkimit. Shqipëria është palë në Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë.¹³

Zhdukja me forcë është një krim sipas ligjit ndërkombëtar dhe përbën shkelje të shumë të drejtave të njeriut, përfshirë:

- e drejta për liri dhe siguri personale,
- e drejta e njohjes si person para ligjit,
- e drejta për të mos iu nënshtruar torturave ose zhdukjes me forcë, trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor ose degradues,
- e drejta për një gjykim të drejtë,
- dhe e drejta për jetë.

Zhdukja me forcë gjithashtu shkel të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të personit të zhdukur dhe familjes së tij ose të saj.

Kur kryhet si pjesë e një sulmi të përhapur ose sistematik kundër çdo popullate civile, zhdukja me forcë është një krim kundër njerëzimit.

Zhdukja me forcë është një krim i vazhdueshëm, pasi shtrihet deri në pikën në të cilën përcaktohet fati dhe vendndodhja e viktimës me siguri.

Edhe kur mund të konkludohet se personi i zhdukur në të vërtetë iu nënshtrua një ekzekutimi arbitrar, për shembull përmes zbulimit të mbetjeve mortore dhe njohjes së sendeve personale, për sa kohë që nuk përcaktohet vendndodhja e atij personi, ose mbetjet nuk janë gjetur dhe identifikuar, situata është ajo e zhdukjes me forcë.

¹³ Report of the Working Group on Enforced or Involuntary Disappearances on its mission to Albania, publikuar në korrik 2017, fq. 5.

6.2 Cilat janë detyrimet e shteteve sipas parashikimeve të legjislacionit ndërkombëtar?¹⁴

Shtetet kanë një detyrim ligjor për të hetuar rastet e zhdukjes me forcë, për të përcaktuar fatin e vendndodhjen e të zhdukurve dhe për të identifikuar e për të ndjekur penalisht ata që janë përgjegjës.

Nëse mbetjet njerëzore të viktimave zbulohen, ekziston një detyrim që shteti të hetojë dhe të përcaktojë shkakun dhe mënyrën e vdekjes, të identifikojë dhe të ndjekë penalisht autorët e krimeve dhe të sigurojë kompensimin e duhur për familjet e viktimave. Shtetet kanë një detyrim të informojnë familjarët e personave të zhdukur për fatin dhe vendndodhjen e të afërmeve të tyre, rrethanat e zhdukjes dhe progresin e hetimit, si dhe përfundimet e tij.

- Konventa Ndërkombëtare e OKB-së “Për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë”, ratifikuar nga RSH me ligjin nr. 9802, datë 13.09.2007,¹⁵

Në këtë konventë, në **nenin 4** parashikohet: “Çdo shtet palë merr masat e nevojshme në mënyrë që zhdukja me forcë të përbëjë një vepër penale, sipas së drejtës së tij penale.”

Neni 5 i saj përcakton se: “Ushtrimi i përgjithësuar ose sistematik i zhdukjes me forcë përbën një krim kundër njerëzimit, ashtu siç përcaktohet nga e drejta ndërkombëtare e zbatueshme, dhe sjell pasojat e parashikuara nga kjo e drejtë.”

Ndërsa në **nenin 6** parashikohet se: “Çdo shtet palë merr masat e nevojshme për të quajtur penalisht përgjegjës më së pakti:

- a) Çdo person që kryen një zhdukje me forcë, e urdhëron ose e porosit atë, tenton ta kryejë, është bashkëfajtor ose merr pjesë në të;*

¹⁴ Missing persons and victims of enforced disappearance in Europe, published by Council of Europe, March 2016, pg. 17&18.

¹⁵ Ligji nr. 9802, datë 13.9.2007, “Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare të OKB-së “Për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë””.

b) Eprorin që:

- i) kishte dijeni që vartës të vendosur nën autoritetin dhe kontrollin e tij efektiv po kryenin ose do të kryenin një krim zhdukjeje me forcë, ose nuk ka marrë parasysh me ndërgjegje të dhëna që e tregonin qartë;
- ii) ushtronte përgjegjësinë dhe kontrollin e tij efektiv mbi veprimtaritë me të cilat ishte lidhur krimi i zhdukjes me forcë; dhe
- iii) nuk ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme që ishin në kompetencën e tij për të penguar ose për të ndëshkuar porositjen e një zhdukjeje me forcë, ose për t'ua dërguar çështjen autoriteteve kompetente për qëllime hetimi a ndjekjeje;

Asnjë urdhër a udhëzim, që vjen nga një autoritet publik, civil, ushtarak a tjetër nuk mund të përdoret për të justifikuar një krim të zhdukjes me forcë.

Zbatimi i kësaj Konvente në Shqipëri monitorohet nga WGEID

- Konventa e OKB-së “Kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese (CAT)”;

Në **nenin 2** të kësaj konvente parashikohet se: “1. Çdo shtet palë merr masa efektive legislative, administrative, gjyqësore, ose masa të tjera për të parandaluar veprimet e torturës në cilindo territor nën juridiksionin e tij. 2. Asnjë rrethanë e jashtëzakonshme, e çfarëdo lloji, qoftë gjendje e luftës ose kërcënim nga lufta, paqëndrueshmëri e brendshme politike apo çdo gjendje tjetër e jashtëzakonshme, nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën. 3. Urdhri i dhënë nga një epror ose autoritet publik nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën.”

Neni 4 parashikon: “1. Çdo shtet palë siguron që të gjitha veprimet e torturës të konsiderohen vepra penale nga ligji i tij penal. E njëjta gjë vlen për tentim ushtrimin e torturës dhe për çdo veprim tjetër të kryer nga çdo person si pjesëmarrës në torturë apo në bashkëveprim. 2. Çdo shtet palë do të japë dënime përkatëse për këto vepra penale duke marrë parasysh seriozitetin e tyre.”

Në **nenin 14** citohet qartë se: “1. Çdo shtet palë, në sistemin e vet juridik, i siguron viktimës së një akti të torturës të drejtën për të kërkuar reparacion dhe për t’u dëmshpërblyer me drejtësi dhe në mënyrë adekuate, duke përfshirë mjetet e nevojshme për riaftësim sa më të shpejtë. Në rast të vdekjes së viktimës si pasojë e një veprimi të torturës, ata që kanë pasur pasoja prej saj kanë të drejtë për dëmshpërblim.”

Komiteti kundër Torturës (CAT), në raportin e tij të vitit 2012 në lidhje me **nenin 14** të Konventës sqaron se: “...Komiteti konsideron se termi ‘dëmshpërblim’ në **nenin 14** përfshin konceptet e ‘kompensimit efektiv’ dhe ‘rehabilitimit’.

Koncepti gjithëpërfshirës riparues përfshin kthimin, kompensimin, rehabilitimin, kënaqësinë dhe garancitë e mospërsëritjes dhe i referohet fushës së plotë të masave të kërkuara për të korrigjuar shkeljet sipas Konventës...”

- Konventa Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”¹⁶

Të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Europës, përfshirë Shqipërinë, kanë nënshkruar Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i krijuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në vendet anëtare.

¹⁶ Ligj nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

Gjykata zakonisht analizon rastet e zhdukjes me forcë në lidhje me nenet 2 (e drejta për jetë), 3 (ndalimi i torturës), 5 (e drejta për liri dhe siguri) dhe 13 (e drejta për një mjet efektiv juridik) të KEDNJ-së. Ky i fundit lexohet së bashku me nenet 2 dhe 3. Në të gjitha rastet e zhdukjes me forcë të gjykuar deri më tani, Gjykata ka gjetur një shkelje të **nenit 5** të Konventës. Sidoqoftë, duke pasur parasysh natyrën dhe specifikat e saj jashtëzakonisht serioze, zhdukja me forcë nuk mund të kuptohet vetëm si një formë e rënduar e ndalimit arbitrar; kjo sjell shkelje të të drejtave të tjera të njeriut gjithashtu. Në rastin e shkeljes së neneve 2 dhe 3 të Konventës në lidhje me personin e zhdukur, Gjykata vlerëson jo vetëm nëse vepra përfshin aspektin thelbësor të dispozitave, por gjithashtu atë procedural, i cili kërkon që shtetet të kryejnë një hetim efektiv në krimin e pretenduar.

Një hetim i tillë duhet të fillojë *ex officio* dhe disa tipare të veçanta të një hetimi efektiv, të tilla si pavarësia dhe paanësia, mjaftueshmëria, shpejtësia dhe vëzhgimi publik, duhet të përmbushen, çfarëdo forme që të marrë hetimi. Në veçanti, viktimat ose të afërmit e tyre duhet të përfshihen në procedurë në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre.¹⁷

Gjykata gjithashtu ka pohuar se detyrimi procedural që rrjedh nga **neni 2** i KEDNJ-së është i veçantë dhe autonom nga detyrimet thelbësore dhe mund të konsiderohet si “i shkëputur”, duke detyruar kështu shtetet të hetojnë gjithashtu edhe kur zhdukja ose vdekja e viktimës ndodhi para hyrjes në fuqi të KEDNJ-së për shtetin në fjalë. Detyrimi procedural vazhdon për aq kohë sa në mënyrë të arsyeshme mund të priten masa për të sqaruar rrethanat e shkeljes dhe për të vendosur përgjegjësinë.¹⁸

¹⁷ Missing persons and victims of enforced disappearance in Europe, published by Council of Europe, March 2016, pg. 38.

¹⁸ *ibid*, pg. 39.

7

TË DREJTAT E FAMILJARËVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR SIPAS LEGJISLACIONIT TË BRENDSHËM

7.1 Çfarë të drejtash kanë sipas ligjit për kompensimin e ish-të dënuarve politikë¹⁹?

a. E drejta për dëmshpërblim financiar

Ligji “Për kompensimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist” u miratua nga parlamenti shqiptar më 15 korrik 2004 me 70 vota pro, dy kundër dhe një abstenim. Subjektet e këtij ligji, ish-të përndjekurit politikë, duhej të kompensoheshin për një periudhë 10 deri në 15-vjeçare, përmes pagesave mujore që ndryshonin në shumë në varësi të llojit të përndjekjes dhe pasojave të pësuar. Ky ligj dhe disa akte nënligjore për zbatimin e tij ofronin kompensim për kategoritë e mëposhtme: të dënuar me burg; të dënuar me vdekje me vendim të gjykatës; vrasjet pa gjyq; izolim në zyrat e hetimit; shtrimi në një institucion mjekësor; mërgim. Më pas në zbatim të këtij ligji u miratua vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 933,

¹⁹ https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Ligj_per_demshperblim-in_e_ish_te_denuarve_politike_te_regjimit_komunist-1.pdf

datë 17.11.2010, “Për përcaktimin e procedurave administrative të shqyrtimit të kërkesave dhe kompensimin financiar për familjet e viktimave të dënuara pa të drejtë, pa gjyq, për arsye politike, nga 30.11. 1944 deri më 1.10.1991“, i ndryshuar.²⁰

Sidoqoftë, kompensimi raportohet se është i kufizuar vetëm te personat që posedojnë dokumente që vërtetojnë statusin e tyre (ose anëtarëve të familjes së tyre) si persona të persekutuar politikë. Kjo lë shumë familje të viktimave të zhdukjes me forcë jashtë sferës së ligjit.²¹

Neni 6

Masa e dëmshpërblimit për të burgosurit, të internuarit ose të dëbuarit politikë.

Masa e dëmshpërblimit për të burgosurit, të internuarit ose të dëbuarit politikë do të jetë si më poshtë:

- a) *çdo i dënuar politik, për çdo ditë vuajtjeje dënimi të kryer, në burg, spital psikiatrik, spital burgu, izolim në hetuesi, nga data 30.11.1944 deri më 1.10.1991, dëmshpërblehet financiarisht, sipas kritereve të këtij ligji, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në ditë;*
- b) *për personat që kanë vuajtur internim në kamp me rrethim me tela me gjemba deri në vitin 1954, masa e dëmshpërblimit është 1 000 (një mijë) lekë në ditë;*
- c) *për personat e tjerë të internuar ose të dëbuar parashikohet një skemë pensioni, e cila do të rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Dëmshpërblimi i përcaktuar në paragrafin më sipër u takon dhe familjarëve të tij, në pjesë të barabarta takuese, kur i dënuari nuk jeton më. E drejta e familjarëve për të kërkuar dëmshpërblim është e drejtë jopasurore vetjake.*

²⁰ Fletore Zyrtare nr. 167, data e publikimit në Fletore Zyrtare 15.12.2010, e aksesueshme në https://qbz.gov.al/share/zGoS900qTpCtFTwt-6eOVg_

²¹ “Shqipëri, personat e zhdukur gjatë periudhës komuniste: vlerësimi i nevojave”, botim i ICMP, gusht 2020, fq. 6.

Nga shuma që çdo i dënuar politik përfiton nga ky ligj, zbritet masa e dëmshpërblimit që ai ka përfituar me ligjet e mëparshme.

Neni 7

Masa e dëmshpërblimit për familjarët e të dënuarve me dënim kapital.

Familjarët e viktimave, të pushkatuara apo të ekzekutuara me dënim politik të padrejtë, për vuajtjen dhe persekucionin, përfitojnë një dëmshpërblim financiar të barabartë, gjithsej, në masën e 8 vjetëve kompensim dënimi me burgim. E drejta e familjarëve për të kërkuar dëmshpërblim është e drejtë jopasurore vetjake.²²

Ligji për kompensimin e ish-të burgosurve politikë, datë 12 dhjetor 2007, i ndryshuar në vitin 2009 dhe së fundmi në vitin 2014, përcakton kushtet për marrjen e kompensimit financiar për viktimat e përndjekjes politike nën regjimin komunist, të cilët ishin subjekt i dënimeve të padrejta, siç janë burgimi ose masat e detyrueshme mjekësore. Ligji parashikon kompensim për familjet e viktimave, në **nenin 1** të tij parashikohet: “Dëmshpërblimi i viktimave, të vrara ose të ekzekutuara gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991, jepet vetëm për familjarët e përcaktuar sipas këtij ligji.”

Në **nenin 2** të këtij ligji përcaktohet se: “Qëllimi i këtij ligji është dhënia e dëmshpërblimit financiar nga shteti shqiptar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, për familjarët e viktimave të ekzekutuara dhe personat e internuar ose të dëbuar në kampe, si një angazhim i shtetit demokratik në dënimin e krimeve të regjimit totalitar komunist dhe garantimin për ta të një jete më të mirë. Dëmshpërblimi financiar, sipas këtij ligji, nuk përjashton marrjen e masave të tjera, të njëkohshme ose të

²² Ligj nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist” https://www.drejtesia.gov.al/wpcontent/uploads/2017/11/Ligj_per_demshperblimin_e_ish_te_denuarve_politike_te_regjimit_komunist-1.pdf.

mëvonshme, ligjore apo administrative, në dobi të të persekutuarve e të dënuarve politikë, të cilat i shërbejnë rivendosjes së drejtësisë dhe dinjitetit shoqëror të kësaj shtrese apo krijimit të kushteve favorizuese, për riintegrimin shoqëror të tyre.”

- **Kush mund të përfitojë?**

Sa i përket rrethit të familjarëve që përfitojnë kompensim nga ligji, kjo përcaktohet qartë në **nenin 8**: “1. Në kuptim të këtij ligji, me familjarë nënkuptohen, pavarësisht nga rregullime të tjera ligjore, paraardhësit, bashkëshortja, pasardhësit, vëllezërit dhe motrat e ish-të dënuarit politik, si dhe fëmija/ fëmijët e vëllezërve dhe motrave. 2. Familjarët, në shkallë më të parë, sipas Kodit Civil, përjashtojnë familjarët e tjerë.”

- **Kujt i drejtohet kërkesa për kompensim financiar dhe çfarë dokumentesh duhen paraqitur?**

Duhet paraqitur kërkesë me shkrim për përfitimin e dëmshpërblimit financiar, për dënimin penal të padrejtë në Ministrinë e Drejtësisë sipas formularit të paraqitur në aneksin “A”, që i bashkëlidhet këtij ligji.²³

²³ Për të shkarkuar formularin ndiqni linkun: https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Ligj_per_demshperblimin_e_ish_te_denuarve_politike_te_regjimit_komunist-1.pdf.

7.2 Cilat janë të drejtat sipas ligjit nr. 7514, datë 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, i ndryshuar,²⁴ dhe ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i ndryshuar.²⁵

E drejta për rehabilitim - e parashikuar në ligjin nr. 7514/1991, i ndryshuar, garanton:

- Rehabilitimin financiar dhe jomaterial të ish-të persekutuarve politikisht. Në veçanti, personat e përndjekur politikë janë amnistuar dhe një seri masash kërkojnë të kompensohen dëmet e pësuar, siç është njohja e kohës së shërbyer në burg ose në internim për qëllime pensioni dhe lejimi i kthimit në vendet e banimit, si dhe vënia në dispozicion e trajnimeve që lidhen me programet e punësimit. Për më tepër, këto ligje vënë në dispozicion kompensimin për humbjet ekonomike të pësuar si rezultat i përndjekjes politike.²⁶
- **Neni 1:** Janë të pafajshëm dhe quhen të padënuar për efekte morale, politike, sociale dhe ekonomike të gjithë personat që janë dënuar për agjitacion e propagandë kundër shtetit, për arratisje, për sabotim, për krijimin ose pjesëmarrjen në organizata politike, për moskallëzim të krimeve kundër shtetit, ata që janë dënuar për shpifje e fyerje kundër organeve më të larta të shtetit e të Partisë, për shkelje të dekretit nr. 7459, datë 22.1.1991, “Për respektimin dhe mbrojtjen

²⁴ Ligji nr. 7514, datë 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, i ndryshuar, i aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/share/LJdNfSIuSDCUiUVQFBenMQ>.

²⁵ Ligji nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i ndryshuar, i aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/share/-q2o6IVkT3qDuncdy-RCEQ>.

²⁶ “Shqipëri, personat e zhdukur gjatë periudhës komuniste: vlerësimi i nevojave”, botim i ICMP, gusht 2020, fq. 6.

e monumenteve që lidhen me historinë kombëtare dhe të simboleve shtetërore», si dhe për shkelje të dekretit nr. 7408, datë 31.7.1990, “Përmbledhjet, grumbullimet dhe manifestimet e shtetasve në vendet publike”.

- **Neni 5:**

- a) T’u njihet e vlefshme për efekt vjetërsie në punë ose shërbim, koha e vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë dhe me internim si dënim penal plotësues. Vjetërsia në punë për kohën e vuajtjes së dënimit u njihet edhe personave që kanë qenë pa punë para fillimit të ndjekjes penale. Për efekt të llogaritjes së pensionit, personat e dënuar gëzojnë të drejtën e zgjedhjes së pagës mesatare mujore të marrë gjatë tre vjetëve me radhë brenda dhjetë vjetëve të fundit të punës, para ose pas procedimit penal, ose të pagës së marrë nga punëtori që ka punuar me kushte të njëjta pune me atë që ka kryer i dënuari gjatë vuajtjes së dënimit. Kur kjo zgjedhje nuk mund të bëhet për shkaqe të ndryshme, atyre u jepet pensioni mesatar.

Për efekt të pensionit, koha e vuajtjes së dënimit me heqje lirie të njihet sa dyfishi i saj.

- b) T’u kthehen titujt e nderit dhe dekoratat që u janë hequr me vendim të gjykatës ose me dekret të presidentit të Kuvendit Popullor.
- c) T’u sigurohet kthimi në qendrën e banimit ku kanë qenë para ndjekjes penale ose internimit, t’u sigurohet punë sipas profesionit të tyre, me përparësi brenda ose jashtë shtetit, dhe t’u jepet precedencë për strehim.
- ç) T’u kthehet e drejta e studimit në shkollat e larta atyre që u është hequr kjo e drejtë për shkak të procedimit penal të tyre ose të personave të afërm dhe t’u sigurohet arsimimi sa më i shpejtë brenda ose jashtë shtetit.

ç/1) Ish-të burgosurve politikë, për kohën e qëndrimit në burg ose në kampet e punës, dhe ish-të internuarve për motive politike deri në datën 31.12.1954, të internuarve në kampet e internimit Radostinë, Levan, Kuç deri në 31.12.1958 dhe të internuarve në kampin e internimit Zvërnec deri më 31.12.1961 si dhe të internuarve në Kurbnesh të Mirditës deri më datë 31.12.1966, t'u jepet dëmshpërblimi sipas rregullave që do të vendosen në dispozita të veçanta në përputhje me kriteret ndërkombëtare, si dhe diferenca e pensionit që nga koha e lindjes të së drejtës për përfitimin e tij. Të drejtën e pensionit e përfitojnë fëmijët e ish-të burgosurve politikë që vazhdojnë studimet pavarësisht nga mosha.

d) U bëhet kompensimi për dëmet e shkaktuara dhe u jepet një shpërblim i caktuar për plotësimin e kushteve të jetesës, sipas rregullave që do të vendosen me dispozita të veçanta në përputhje me kriteret ndërkombëtare. U njihet e drejta e kthimit ose e kompensimit të pasurive të konfiskuara.

d/1) Dëmshpërblimi për kohën e qëndrimit në burg ose në kampet e punës si dhe diferenca e pensionit u jepet edhe familjeve të ish-të burgosurve politikë që nuk jetojnë më dhe ish-të internuarve për motive politike deri në datën 31.12.1954, të internuarve në kampet e internimit Radostinë, Levan, Kuç deri në 31.12.1958 dhe të internuarve në kampin e internimit Zvërnec deri më 31.12.1967. U njihet e drejta e kthimit të pasurive të konfiskuara ose e kompensimit të këtyre pasurive deri në masën që përfitojnë të gjithë të shpronësuarit e tjerë me ligje e vendime të veçanta.

dh) Kompensimi për dëmet e shkaktuara u jepet edhe familjeve ose trashëgimtarëve të ligjshëm të ish-të burgosurve politikë që nuk jetojnë më, ish-të internuarve për motive politike deri në datën 31.12.1954, të internuarve në kampet e internimit Radostinë, Levan, Kuç deri në 31.12.1958 dhe të internuarve

në kampin e internimit Zvërnec deri më 31.12.1967, si dhe të atyre që janë të pushkatuar pa gjyq ose që kanë vdekur pa u dënuar nga gjykata.

- e) Përfitojnë pension, sipas dispozitave për pensionet familjare, familjarët e të pushkatuarve dhe të dënuarve pa gjyq, të të vdekurve në burg dhe të ish-të internuarve për motive politike deri në datën 31.12.1954, të internuarve në kampet e internimit Radostinë, Levan, Kuç deri në 31.12.1958 dhe të internuarve në kampin e internimit Zvërnec deri më 31.12.1967 ose të atyre që kanë vdekur në burg pa u dënuar me gjyq.

E drejta për të përfituar statusin e ish-të persekutuarit/dënuarit politik – u garantua me ligjin nr. 7748/1993, duke përcaktuar saktë në të kriteret për të përfituar këtë status dhe të drejta të tjera lidhur me të.

Është me interes të përmendet se për herë të parë në këtë ligj jepet përkufizimi i “**përndjekjes politike**”. **Neni 2** i këtij ligji përcakton se:

Përndjekje politike, që më poshtë do të quhet “përndjekje”, quhet çdo veprim ose mosveprim i kryer që nga data 8.11.1941 deri më datën 22.3.1992 nga ana e çdo formacioni ose individi të armatosur, e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, e sigurimit të shtetit, e policisë, e ushtrisë apo nga ana e organeve të pushtetit lokal me urdhër ose vendim të organeve partiake, luftarake, shtetërore apo të gjykatave të komunistëve shqiptarë, kur ky veprim ose mosveprim ka shkaktuar humbjen e jetës, të lirisë, të të drejtave qytetare, cilësimin kulak, i deklasuar, si dhe çdo privim tjetër nga pjesëmarrja në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të individit për hir të bindjeve apo qëndrimit të tij politik a fetar.

E drejta e kompensimit në vlerë – është një nga të drejtat e garantuara në ligjin për statusin e të përndjekurit politik.

Kompensimi pasuror i të përndjekurve politikë, sipas **nenit 7** të këtij ligji, do të quhet: shpërblimi i menjëhershëm me të holla, pensioni jetësor, kompensim rroge, tokë, lokal dhe forma të tjera përfitimi material, të cilat do t'i jepen personit të përndjekur ose familjes së tij kur ai ka vdekur, pa kthim, në kompensim të jetës, humbjes së lirisë, punës së papaguar dhe vuajtjeve, duke pasur si qëllim kryesor krijimin e kushteve dhe të mundësive për një integrim sa më të shpejtë të tij dhe të familjes së tij në jetën normale ekonomiko-shoqërore të vendit tonë. Forma e kompensimit pasuror përcaktohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Të drejta të tjera – Neni 12 i ligjit 7748/1993 parashikon se:

Të gjithë atyre personave që përfshihen në **nenin 3**, pikat a, b, c dhe d, Qeveria me anë të akteve të veçanta të saj do t'iu garantojë krijimin e lehtësirave dhe të përparësive të kërkesave të tyre individuale apo kolektive në fushat e mëposhtme të veprimtarisë ekonomike, financiare dhe sociale: a) Në fushën e privatizimit të pronës shtetërore b) Në fushën e dhënies së kredive c) Në fushën e ndërtimeve dhe strehimit d) Në fushën e turizmit e) Në fushën e arsimit dhe të kualifikimit f) Në fushën e punësimit brenda dhe jashtë vendit g) Në fushën e realizimit të programeve të ndryshme ekonomike dhe sociale kombëtare dhe ndërkombëtare h) Në fushën e shërbimit shëndetësor. Afati i përfundimit të këtyre përparësive vendoset me ligj të veçantë.

A kanë të drejtë familjet e të zhdukurve për ndihmë juridike falas?

Ndihma ligjore falas rregullohet me ligjin nr. 111/2017²⁷ dhe përcakton qartë të gjitha kategoritë vulnerabël që përfitojnë mbrojtje ligjore falas. Ky ligj krijon mundësitë që prej tij të përfitojnë edhe pjesa më vulnerabël e të përndjekurve politikë, të cilët mund të jenë të papunë, të pastrehë apo që përfitojnë nga skema të mbrojtjes sociale.

Sipas ligjit, të përndjekurit politikë kanë të drejtë për ndihmë juridike parësore dhe dytësore. Për më tepër, ky ligj, **neni 3**, shpjegon:

- a) “Ndhimë juridike” është shërbimi juridik falas dhe shërbimet e tjera të parashikuara në këtë ligj, për personat që përmbushin kriteret e këtij ligji, të cilat garantohen dhe financohen nga shteti.
- b) “Ndhimë juridike parësore” është: i) dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor; ii) dhënia e këshillimit; iii) dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alter-native të mosmarrëveshjeve; iv) dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore; v) përfaqësimi përpara organeve administrative; dhe vi) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.
- c) “Ndhimë juridike dytësore” është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislationit procedural penal.

²⁷ Ndhimë ligjore falas: <https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/LIGJ-nr.-111-2017-date-14.12.2017.pdf>

Familjet e personave të zhdukur dhe/ ose të persekutuar më parë, që plotësojnë ndonjë nga kriteret e **nenit 11** më poshtë, kanë të drejtë të marrin ndihmë juridike falas.

Ndihma juridike u ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre: a) viktimave të dhunës në familje; b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal; c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal; ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore; d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor; dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit; e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor; ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore; f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi; g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor; gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale; h) personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Personat e interesuar të cilët janë të interesuar të aplikojnë për ndihmë juridike falas siç ofrohet nga Ministria e Drejtësisë - Drejtoria e Ndhmës Juridike, mund të vizitojnë uebfaqen këtu²⁸ dhe të vizitojnë zyrat e Drejtorisë.

²⁸ <https://ndihmajuridike.gov.al/>.

8

A KA NJË PROCES TË QARTË NË SHQIPËRI PËR TË GJETUR, PËR TË RIKUPERUAR DHE PËR TË IDENTIFIKUAR MBETJET NJERËZORE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR?

Ka shumë pak raste të rikuperimit dhe identifikimit të rasteve të personave të zhdukur në Shqipëri. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Qeverisë Shqiptare dhe ICMP, në fillim të vitit 2019, mbetjet mortore të dy personave të zhdukur, të varrosur në malin e Dajtit, pjesë e grupit, u gjetën dhe u identifikuan përmes krahasimit të profileve gjenetike të ADN-së.

Aktualisht, nuk ka ndonjë proces të rregulluar të gjetjes, identifikimit dhe rikuperimit të mbetjeve mortore, megjithëse ka përpjekje për ta zyrtarizuar atë.

Për sa më sipër shtrohen disa pyetje:

8.1 A ka Shqipëria detyrimin të hetojë rastet e personave që u zhdukën gjatë periudhës së regjimit komunist?

Detyrimi për të kryer hetime gjithëpërfshirëse dhe efektive të abuzimeve të të drejtave të njeriut i takon shtetit, pavarësisht se kush ka kryer shkelje dhe abuzime (aktorë shtetërorë apo joshtetërorë). Moshetimi i fatit dhe vendndodhjes së personave të zhdukur në një mënyrë efektive, përfshirë rrethanat e zhdukjes së tyre, mund të përbëjë një shkelje të vazhdueshme të të drejtave themelore të njeriut si për personat e zhdukur ashtu edhe për anëtarët e familjes së tyre.

Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare, që Shqipëria nënshkroi më 18 korrik 1998 dhe depozitoi instrumentin e saj të ratifikimit të Statutit të Romës në 31 janar 2003, parashikon krimin e zhdukjes me forcë si një krim kundër njerëzimit. Ky instrument ligjor parashikon detyrimet e shteteve për të kryer hetime efektive në lidhje me personat e zhdukur. E drejta për jetën në veçanti qëndron në garancinë procedurale që abuzimet do të hetohen zyrtarisht.

8.2 A ekziston një parashkrim që i ndalon prokurorët të hetojnë rastet e personave të zhdukur nga periudha komuniste?

Një parashkrim kufizon afatin maksimal kohor gjatë të cilit procedurat ligjore, përfshirë një hetim penal, mund të fillojnë pas një veprë të dyshuar penale. Në Shqipëri, **neni 66** i Kodit të Procedurës Penale rregullon parashkrimin e ndjekjes penale si 20 vjet nga koha e veprës për të cilën ligji parashikon një dënim me dhjetë vjet burgim.

Statuti i parashkrimit nuk mund të thirret si bazë për të mos filluar një hetim për çështjet e personave të zhdukur nga epoka komuniste për shkak të faktit se zhdukja me forcë e personave të zhdukur është një veprim i vazhdueshëm. Akti fillon në kohën e zhdukjes së individit dhe zgjatet për tërë periudhën kohore që krimi nuk është i plotë,

domethënë derisa shteti të japë informacione që kanë të bëjnë me fatin ose vendndodhjen e mbetjeve njerëzore të personit të zhdukur.

Duke pasur parasysh se zhdukja me forcë është një krim kundër njerëzimit, siç përcaktohet në Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, duhet të theksohet se **neni 67** i Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë thotë se nuk ka parashkrim për ndjekjen penale të krimeve kundër njerëzimit.

8.3 Cilat janë parimet e praktikave më të mira që duhet të zbatohen për të adresuar çështjen e personave të zhdukur në Shqipëri?²⁹

Në Forumin e Paqes Paris më 12 nëntor 2018, Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) rishikoi Deklaratën e ICMP mbi rolin e shtetit në adresimin e çështjes së personave të zhdukur si pasojë e konfliktit të armatosur dhe abuzimit me të drejtat e njeriut me qëllim promovimin e zbatimit të parimeve të Deklaratës në mënyrë universale dhe në të gjitha rrethanat kur personat zhduken, përfshirë katastrofat, krimin e organizuar, migracionin e parregullt dhe shkaqe të tjera. Tetë «Parimet e Parisit» pasqyrojnë dhe avancojnë një konsensus global në zhvillim për mënyrën e adresimit të çështjes së personave të zhdukur.

1. Përgjegjësia e shtetit

Shtetet mbajnë një përgjegjësi për sigurimin e paqes së qëndrueshme, pajtimit dhe kohezionit shoqëror – zgjidhja e fatit të personave të zhdukur dhe mbrojtja e personave nga zhdukja është një element integral në sigurimin e këtij objekti.

²⁹Referojuni Parimeve të Parisit të ICMP në linkun: <https://www.icmp.int/?resources=the-paris-principles>.

2. Të drejtat materiale

E drejta për dinjitet dhe jetë, e drejta për të mos iu nënshtruar torturave ose trajtimeve poshtëruese, e drejta për një jetë familjare dhe privatësi dhe e drejta për t'u njohur si person para ligjit – të gjitha thirren kur një person humbet ose është viktimë e zhdukjes me forcë.

3. Kapacitetet

Hetimet janë të besueshme vetëm nëse janë të afta të vërtetojnë faktet – kapacitetet adekuate nuk mund të sigurohen *ad hoc* ose përmes filantropisë: ato kërkojnë përpjekje zyrtare dhe të qëndrueshme dhe dispozita të përthershme.

4. Bashkëpunimi

Çështja e personave të zhdukur nuk respekton kufijtë: ajo ka një dimension ndërkombëtar – bashkëpunimi midis shteteve dhe me institucionet ndërkombëtare është një element i domosdoshëm në masat efektive për të dhënë llogari për të zhdukurit. Hetimet efektive mbi çështjen e të zhdukurve nuk mund të kryhen veçmas, por kërkojnë bashkëpunim midis autoriteteve dhe me organizatat ndërkombëtare, që shkëmbejnë informacione mbi të zhdukurit për të mbrojtur të drejtat e viktimave. Bashkëpunimi është efektiv nëse siguron pjesëmarrjen dhe fiton besimin e familjeve të të zhdukurve. Të drejtat kryesore të njeriut në lidhje me pjesëmarrjen e familjeve përfshijnë të drejtat e lirisë së shprehjes dhe shoqërimit.

5. Të drejtat procedurale

Të drejtat kanë kuptim vetëm nëse hetohen shkeljet dhe abuzimet. Personat që zhduken ose janë viktimë të zhdukjes me forcë kanë të drejtë për mbrojtje sipas ligjit; të afërmit dhe të tjerët afër një personi të zhdukur kanë të drejtën për një hetim efektiv.

6. E vërteta


E drejta për të vërtetën do të thotë që rrethanat e zhdukjeve bëhen të ditura – përfshirë përcaktimin e shkakut dhe mënyrës së vdekjes në rastet kur personi i zhdukur ka vdekur. Proceset e personave të zhdukur duhet të jenë të afta, përmes mjeteve të besueshme dhe të realizueshme, për të vërtetuar faktet që kanë çuar në humbjen e një personi, përfshirë vdekjen e personit.

7. Drejtësia

Aktiviteti kriminal është pas shumicës dërrmuese të zhdukjeve – sistemi i drejtësisë duhet të drejtojë përpjekjet për të hetuar zhdukjet dhe për të ndjekur penalisht ata që janë përgjegjës.

8. Sundimi i ligjit

Dështimet e rendit të ligjit janë një shkak dhe pasojë e humbjes ose zhdukjes së personave – të gjitha masat për të adresuar çështjen duhet të mbështesin dhe avancojnë shtetin e së drejtës.



**FORMULAR APLIKIMI
PËR TË ZHDUKURIT I AUTORITETIT
PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT**

FORMULAR APLIKIMI

PËR INFORMIM TË TË AFËRMVE TË TË VDEKURVE APO TË TË ZHDUKURVE



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

| | |
|---|--|
| Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: E-mail: info@autoritetidosjeve.gov.al Web: www.autoritetidosjeve.gov.al | HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR PUNON- JËSIT E AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT |
| Shënim: Ju lutemi plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, ME GERMA KAPITALE DHE NË NGJYRË BLU. | |

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN

| | | | |
|----------------------|---|--|---|
| 1. Emri | <input type="text"/> | 3. Mbiemri | <input type="text"/> |
| 2. Emri i babait | <input type="text"/> | 4. NID NR. i identifikimit personal | <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> |
| 5. Gjinia | Mashkull <input type="checkbox"/> Femër <input type="checkbox"/> | 6. Ditëlindja | <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> Data Muaj Viti |
| 7. Vendlindja | <input type="text"/> | 8. Shtetësia | <input type="text"/> |
| 9. Adresa | <input type="text"/> | | |
| 10. Qyteti | <input type="text"/> | 11. Rrethi | <input type="text"/> |
| 12. Kodi postar | <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> | 13. E-mail | <input type="text"/> |
| 14. Nr. Tel. Celular | <input type="text"/> | 15. Nr. Tel. Fiks | <input type="text"/> |

SEKSIONI B: INFORMACION MBI TË PAGJETURIN

16. Emri 17. Mbiemri

18. Emri i babait 19. Emri i nënës

20. Gjinia Mashkull Femër 21. Ditëlindja

22. Shtetësia

23. Adresa

24. Qyteti 25. Rrethi

26. Kërkuesi paraqet kërkesë për informacion në cilësinë e të afërmit të të vdekurit apo të të zhdukurit

Të afërmit të të vdekurve apo të të zhdukurve

Tjetër

27. Arsyeja e paraqitjes së deklaramit të formularit të aplikimit

Për të qartësuar fatin e të vdekurit apo të të zhdukurit

Për rehabilitimin e të vdekurit apo të të zhdukurit

Për ruajtjen e të drejtave të personalitetit të të vdekurit apo të të zhdukurit, në veçanti sqarimi i akuzës së bashkëpunimit me ish-Sigurimin e Shtetit

Tjetër

28. Dorëzon dhe jep pëlqimin

Për intervistim

Kujtime

Dokumentacion

Të drejtën për komunikim me institucionet

29. Të dhëna për lehtësimin e identifikimit të dokumentacionit arkivor. Të përcaktohet:
- i) vendi ku ka ndodhur ngjarja;
 - ii) koha kur ka ndodhur ngjarja, data, muaji, viti; iii) procesi politik dhe dënimi;
 - iv) vendi i ekzekutimit të dënimit;
 - v) vendi i ekzekutimit të dëbim/internimit; si dhe çdo detaj apo e dhënë tjetër që lehtëson kërkimin e të dhënave t'i bashkëlidhet dokumentacionit shoqërues, nëse ka.

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

- Fotokopje të kartës së identitetit
- Prokurë, kur aplikimi paraqitet nga një përfaqësues i autorizuar
- Dokument, që vërteton lidhjen familjare (dëshmi trashëgimie/certifikatë etj.)

Ky formular nuk ndalon aplikantin të vazhdojë kërkimet edhe në institucione apo burime të tjera, ku ai e sheh të arsyeshme. E drejta e kërkimit për informimin dhe vënia në dispozicion e dokumenteve sipas ligjit nr 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit, të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" ushtrohet nga kërkuesit e individëve, duke iu drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet shërbimit postar ose pranë zyrës së informimit të Autoritetit

Nënshkrimi i Aplikantit

| | | | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|
| | | | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|

Data

Muaj

Viti

